Neleta Bardhi Meridiana Nepravishta

# LIBËR PËR MËSUESIN
# Qytetaria 6

BOTIME
pegi

# Përmbajtje

Çfarë na orienton dhe kërkon
programi i qytetarisë 5

Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me
kompetencat e tjera kyçe 6

Modeli i planifikimit vjetor 12

Planifikimi i orës mësimore (modele skematike) 14

# 1. Çfarë na orienton dhe kërkon programi i qytetarisë

**Qëllimet e programit**

Programi i qytetarisë për shkallën 3 **synon**:

- të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehi demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i **lëndës së qytetarisë synon:**

- T'u japë nxënësve mundësinë të për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.

- T'u japë nxënësve mundësinë të për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

- T'u japë nxënësve mundësinë të të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Diagrama 1: **Korniza konceptuale e programit**




## Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen me kompetencave e tjera kyçe. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënit.

### Kompetenca qytetare

*Programi i qytetarisë, si pjesë e fushës Shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare*.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës qytetaria nxisin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

### Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i *qytetarisë* krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj, nxënësi zhvillon shkathtësi të të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin

e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.

**Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i *qytetarisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik për interpretimin e të dhënave etj.

**Kompetenca e të nxënit**

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstron respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

**Kompetenca personale**

Programi i qytetarisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

**Kompetenca digjitale**

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

**Diagrama 2: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë**

**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)***

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim,si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme,duke bërë pyetje, komente,sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj.,e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

**Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)***

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie.
- Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).
- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

**Kompetenca e të nxënit *(Nxënësi mëson për të nxënë)***

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim(tekst shkollor, libër, internet, medie)për të nxënë një temë,veprim,aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike)sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti(në klasë/shkollë apo në terren).

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.)për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/ aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme)***

- Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

**Kompetenca qytetare *(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)***

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik,fetar,gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

**Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

### 1.1. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësisë qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për Zhvillimin e qëndrueshëm dhe Mjedisin.

Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënit në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendje hapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

**VLERËSIMI**

Standardet e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

**Njohuritë** përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuara gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

**Aftësitë intelektuale** e **pjesëmarrëse** të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

**Aftësitë intelektuale** i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

**Aftësitë pjesëmarrëse** i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë

marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një të rëndësishëm në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë *edhe matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë* përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë prirjet qytetare që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur "rregullave të lojës", si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme,
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar**.

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohet të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

**Në sa mënyra vlerëson mësuesi?**

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara.

Përdorimi i portofolit, si një koleksion sistematik i punës së nxënësve, siguron një tablo të plotë të zhvillimit e të progresit të nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai u afron nxënësve gjithashtu mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.



# Planifikimi vjetor

- **PLANI MËSIMOR VJETOR - KLASA VI**
- **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
- **LËNDA: QYTETARI**

| **Tematikat** | **Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave** | | |
|---|---|---|---|
| | **Shtator – Dhjetor 15 orë** | **Janar – Mars 12 orë** | **Prill – Qershor 8 orë** |
| **Tematika 1: Komuniteti**<br><br>**Orë të sugjeruara: 13 orë** | 1. Nevojat dhe Shërbimet<br>2. Institucionet<br>3. Përgjegjësitë e qeverisjes vendore<br>4. Shërbimet që ofrohen në komunitet<br>5. Shërbime për grupet në nevojë<br>**6. Projekt – ora e parë**<br>**Si të realizojmë një vlerësim të nevojave për komunitetin e të moshuarve**<br>7. Vullnetarizmi<br>8. Vlerësimi i nevojave dhe i burimeve<br>9. Cilësia e shërbimeve<br>10. Pjesëmarrja në jetën e komunitetit<br>11. Kontributi im për komunitetin<br>**12. Projekt – ora e dytë**<br>**Si të realizojmë një vlerësim të nevojave për komunitetin e të moshuarve**<br>**13. Testim -Tematika 1: Komuniteti** | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Tematika 2: Kultura**<br><br>**Orë të sugjeruara: 13 orë** | 1. Dita e kulturës<br>2. Festat tradicionale | 1. Arti i gatimit<br>2. Shumëllojshmëria kulturore<br>3. Rolet dhe stereotipat gjinorë<br>4. Tradita e emrit<br>5. Kultura dhe shëndeti<br>6. Dallimet kulturore<br>7. Konfliktet me bazë kulturore<br>8. Të mos diskriminojmë<br>9. Mënyrat e zgjidhjes së konfliktit<br>10. Dita e tolerancës<br>**11. Përsëritje: Tematika II**<br>12. Testim -Tematika 2: Kultura | |
| **Tematika 3: Tregu global[1]**<br><br>**Orë të sugjeruara: 9 orë** | | Tregtia | 1. Tregtia<br>2. Barrierat dhe marrëveshjet tregtare<br>3. Bëjmë një marrëveshje<br>4. Roli i individëve si burime njerëzore<br>5. Bota e fjalëve<br>6. Bota e parave<br>7. **Testim - Tematika 3: Tregu global**<br>8. **Veprimtari: Jeta ime** |

[1] Këto tema mësimore janë përgatitur nga Junior Achivement.

# PLANIFIKIM 3-MUJORI
# FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI
# LËNDA: QYTETARI

***Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe***

**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)***

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

**Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)***

- Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor... etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

**Kompetenca e të nxënit *(Nxënësi mëson për të nxënë)***.

- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/ aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

| |
|---|
| **Kompetenca qytetare *(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)***<br>• Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë te ndryshëm por të barabartë.<br>• Shpjegon në forma të ndryshme të shprehuri d.m.th. e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia<br><br>**Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik). |
| ***Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës***<br><br>• Liston shërbimet që duhet të kryhen në një komunitet në interes të të gjithë anëtarëve të komunitetit, për krijimin dhe për ruajtjen e një komuniteti të shëndoshë;<br>• Dallon përgjegjësinë e pushtetit vendor në kryerjen e shërbimeve në dobi të komunitetit si: shërbimet publike, rendi dhe qetësia publike, mirëmbajtja dhe mbrojtja e mjedisit etj.;<br>• Identifikon raste kur pushteti vendor nuk i ka kryer si duhet detyrat e tij ndaj komunitetit;<br>• Vjel opinionet e anëtarëve të komunitetit për cilësinë e kryerjes së shërbimeve në komunitet;<br>• Diskuton për disa nga shërbimet komunitare që mund të realizohen më mirë në shërbim të komunitetit dhe sugjeron ide për përmirësimin e tyre;<br>• Përcakton shërbimet komunitare, në të cilat roli i qytetarëve është shumë i rëndësishëm;<br>• Dallon përgjegjësitë e qytetarëve në shërbim të komunitetit, në varësi të llojit të shërbimit;<br>• Vlerëson shkallën në të cilën qytetarët, në komunitetin e tyre, luajnë rolin e tyre në shërbim të komunitetit.<br>• Analizon disa nga shkaqet e pjesëmarrjes së dobët të qytetarëve në komunitet.<br>• Vlerëson shkallën në të cilën ata ndihen përgjegjës për komunitetet në të cilat bëjnë pjesë (shkollë, pallat, lagje etj.);<br>• Shpjegon arsyet e pjesëmarrjes të tyre së ulët në shërbim të komunitetit etj;<br>• Diskuton për mundësitë e rritjes së përgjegjësisë dhe të pjesëmarrjes qytetare në shërbim të komunitetit.<br>• Merr pjesë në mënyrë vullnetare në veprimtaritë e klasës dhe të komunitetit, në emër të së mirës së përbashkët. |

**PLANI MËSIMOR - QYTETARI 6**

**PLANIFIKIM 3-MUJOR SHTATOR - DHJETOR - 15 ORË**

**LËNDA: QYTETARI**

| NR | TEMATIKA (ORË) | TEMAT MËSIMORE | SITUATË E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | VLERËSIMI | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Komuniteti<br>10 orë+<br>2 orë<br>(Tematika kulturë)<br>2 orë projekt<br>1 orë testim** | **1. Nevojat dhe shërbimet** | Njeriu ka disa nevoja bazë dhe për t'i plotësuar këto nevoja kërkohet organizimi i shërbimeve publike dhe jopublike (familjet e përmbytura) | Punë në grup dhe punë individuale me shkrim<br>Diagrama piramidale<br>Ilustrim fotosh<br><br>Bashkëbisedim<br>Ilustrim fotosh<br>Metoda integruese<br><br>Parashikim me terma paraprakë<br>Ilustrim fotosh<br>Kllaster | Vlerësim për të nxënët formues<br><br>Vlerësim individual<br><br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)<br><br>Vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br><br>Vlerësim mes nxënësish;<br><br>Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br><br>Vlerësimi i detyrave të Portofolit | Teksti i nxënësit<br>Burime vetjake nxënësve<br><br>Libri i mësuesit<br><br>Teksti<br>Udhëzues për mësuesin;<br>Informacione<br><br>Teksti<br><br>Skema të krijuara<br>Materiale nga internet |
| 2 | | **2. Institucionet** | Identifikoni institucionet dhe shërbimet që ato afrojnë për të plotësuar nevojat e komunitetit.<br>Familjet e ngujuara | | | |
| 3 | | **3. Përgjegjësitë e qeverisjes vendore** | Shqetësimet e gjyshes së Siborës. Shtoni dhe ju ankesat e familjes suaj. | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | **4. Shërbimet që ofrohen në komunitet** | Lista e institucioneve që ofrojnë shërbime në komunitet. | Nxitja e diskutimit<br>Nxitja për të përsosur të shkruarin<br>Ilustrim fotosh<br>Kllaster | Vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>Vlerësim mes nxënësish;<br>Vlerësimi i punës në grup | Teksti “Qytetari” për klasën VI;<br>Udhëzues për mësuesin |
| 5 | | **5. Shërbime për grupet në nevojë** | Situata e Erës.<br>Njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit që kanë nevojë për kujdes, fëmijët pa prindër dhe familjet pa të ardhura janë grupe në nevojë. | Rrjeti i diskutimit<br>Ilustrim fotosh<br>Kllaster<br>Nxitja për të përsosur të shkruarin | Vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>Vlerësim mes nxënësish;<br>Vlerësimi i punës në grup; | Teksti “Qytetari” për klasën VI;<br>Udhëzues për mësuesin;<br>Informacione skema për temat mësimore |
| 6 | PROJEKT<br>ORA E PARË | **1. Si të realizojë një vlerësim të nevojave për komunitetin e të moshuarve** | Vëzhgohet nga afër gjendja e një grupi të të moshuarve.<br>Nxirren problemet që kanë dhe se si të veprohet për t’i ndihmuar. | Anketim<br>Intervista<br>Pyetësorë<br>Vëzhgim<br>Ekskursion | Vlerësim i detyrave të portofolit<br>Vlerësim mes nxënësish; | Kontakti në shtëpinë e të moshuarve<br>Persona të lagjes<br>Punonjës të pushtetit vendor.... |
| 7 | | **6. Vullnetarizmi** | “Vrapoj për fëmijët” - nismë në ndihmë të fëmijëve jetimë. Po ju? | Nxitja e diskutimit<br>Nxitja për të përsosur të shkruarin. | Vlerësimi i punës në grup; | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | | **7. Vlerësimi i nevojave dhe burimeve** | ... vlerësim i nevojave të komunitetit dhe grupet shoqërore. | Metoda interaktive, bashkëpunuese, gjithëpërfshirëse<br><br>Metoda integruese | Vlerësim diagnostikues<br><br>Vetëvlerësim me listë kontrolli | Informacione skema për temat mësimore<br>Informacione<br>Foto |
| 9 | | **8. Cilësia e shërbimeve** | Intervista e Olës në lidhje me shërbimin shëndetësor. | Parashikim me terma paraprakë<br><br>Kllaster | Vlerësim për të nxënit formues | Informacione<br><br>Foto |
| 10 | | **9. Pjesëmarrja në jetën e komunitetit** | Shembuj konkretë të kontributit në komunitetin tuaj. | Rrjeti i diskutimit<br><br>Shkrim i lirë dhe pema e mendjes. | Vlerësim individual<br><br>Vlerësim në grup | Teksti i nxënësit<br>Foto |
| 11 | | **10. Kontributi im për komunitetin** | Fletëpalosja e Deas | Rrjeti i diskutimit | Vlerësim i detyrave të portofolit | Teksti i nxënësit<br><br>Burime të ndryshme |
| 12 | Projekt<br>Ora e dytë<br><br>TEST<br>TEMATIKA 1 | **2. Projekt - ora e dytë** | Vëzhgohet nga afër gjendja e të moshuarve. Nxirren problemet që kanë dhe si të veprohet për t'i ndihmuar. | Metoda interaktive, bashkëpunuese, gjithëpërfshirëse<br><br>Rrjeti i diskutimit | Detyra individuale<br>Vetëvlerësim dhe vlerësim mes nxënësish<br><br>Me testim<br><br>Vlerësim në grup | Pyetësor<br><br>Fotografi<br><br>Foto të printuara |
| 13 | | **1. Testim Tematika 1** | Kontrollohen njohuritë e marra për tematikën 1. | | Vetëvlerësim dhe vlerësim mes nxënësish | Intervista<br><br>Vëzhgime |
| 14 | | **11. Dita e kulturës** | Dasma e tezes së Arbës.<br>Nxënësit tregojnë traditat e familjes së tyre. | Kllaster<br><br>Diagrama e venit | Vlerësim me anë të portofolit | Materiale nga interneti |
| 15 | | **12. Festat tradicionale** | 14 Marsi - Dita e Verës | | | |

## PLANIFIKIM 3-MUJOR JANAR – MARS - 12 ORË

**LËNDA: QYTETARI**

| NR | TEMATIKA (ORË) | TEMAT MËSIMORE | SITUATË E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | VLERËSIMI | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | **KULTURA**<br><br>**9 orë**<br>**1 orë përsëritje**<br>**1 orë testim** | **1. Arti i gatimit** | Gatimet tradicionale: gjyshja ime | Punë në grup dhe punë individuale me shkrim<br><br>Insert<br>Kubimi<br>Ilustrim fotosh<br>Metoda integruese<br><br>Parashikim me terma paraprakë<br>Ilustrim fotosh<br>Kllaster | Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm<br><br>Vlerësim individual<br><br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)<br><br>Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br><br>Vlerësimi i detyrave të portofolit | Teksti i nxënësit<br><br>Burime vetjake të nxënësve<br><br>Teksti<br><br>Informacione<br><br>Teksti<br><br>Skema të krijuara internet |
| 17 | | **2. Shumëllojshmëria kulturore** | Bledi në shkollën “Demokracia” klasa e VI.... | | | |
| 18 | | **3. Rolet dhe stereotipat gjinore** | Biseda e Gentit dhe e Erës | | | |
| 19 | | **4. Tradita e emri** | Emri im është i veçantë | Brainstorming<br>Ilustrim fotosh<br>Kllaster<br>Shkrim i lirë<br>Ilustrim fotosh<br>Kllaster<br>Nxitja për të përsosur të shkruarin | Vlerësimi i përgjigjeve me gojë<br>Vlerësim mes nxënësish<br><br>Vlerësimi i përgjigjeve me gojë<br><br>Vlerësim mes nxënësish | Teksti<br><br>Foto<br><br>Teksti<br><br>Informacione skema |
| 20 | | **5. Kultura dhe shëndeti** | Njerëzit kanë mendime të ndryshme për kujdesin ndaj shëndetit | | | |
| 21 | | **6. Dallimet kulturore** | Elda është një grua e re dhe e shkathët... | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | | **7. Konflikt me bazë kulturore** | Ekspozitë me veshje tradicionale... | Parashikim me terma paraprakë<br>Kllaster<br><br>Tryeza rrethore<br>Turi i galerisë | Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm<br><br>Vlerësim mes nxënësish<br>Vlerësimi i punës në grup | Teksti i nxënësit<br><br>Burime vetjake të nxënësve<br><br>Teksti i nxënësit<br><br>Burime vetjake të nxënësve |
| 23 | | **8. Të mos diskriminojmë** | ... sot ndeshja nuk ka filluar Ronaldi,.... | Parashikim me terma paraprakë<br><br>Parashikim me terma paraprakë<br>Shkrim i lirë<br><br>Bisedojmë së bashku<br><br>Punë e pavarur | Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm<br><br>Vlerësim për të nxënit formues<br><br>Vlerësim individual<br><br>Vlerësim individual | Informacione<br><br>Foto<br><br>Informacione<br><br>Foto |
| 24 | | **9. Mënyrat e zgjidhjes së konfliktit** | | | | |
| 25 | | **10. Dita e tolerancës** | Genti do të organizojë një festë për ditëlindjen e tij | | | |
| 26 | **Përsëritje** | **1. Përsëritje Tematika Kultura** | Kontrollohen njohuritë e marra për tematikën 2. | | | |
| 27 | **Testim** | **2. Testim Tematika 2** | | | | |

**LËNDA: QYTETARI**

## PLANIFIKIM 3-MUJOR PRILL – QERSHOR 2016 - 8 ORË

| NR | TEMATIKA (ORË) | TEMAT MËSIMORE | SITUATË E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | VLERËSIMI | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | **TREGU GLOBAL**<br><br>**6 orë**<br>**1 orë veprimtari**<br>**1 orë testim** | **1. Tregtia** | Listoni mallra të vendit dhe të importit | Punë në grup<br>Bisedë<br><br>Metoda integruese<br>Veprimtari në grupe | Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm<br><br>Vlerësim individual<br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues) | Teksti i nxënësit<br>Burime vetjake të nxënësve<br><br>Teksti<br>Informacione |
| 29 | | **2. Barrierat dhe marrëveshjet tregtare** | Gjatë shkëmbimeve tregtare ka fitues dhe humbës. | | | |
| 30 | | **3. Bëjmë një marrëveshje** | Si të bëni biznes | Veprimtari praktike<br>Loja me role | Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë<br>Vlerësimi i detyrave të portofolit | Teksti<br>Informacione |
| 31 | | **4. Roli i individëve si burime njerëzore** | Ju dhe familja juaj po përballeni me detyrën e vështirë të emigrimit..... | Bisedë<br>Veprimtari | Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë | Teksti<br>Informacione |
| 32 | | **5. Bota e fjalëve** | Deri në fillim të viteve 1400, librat shkruheshin me dorë.... | Bisedë<br>Shkrim i lirë<br>Veprimtari | Vlerësimi i përgjigjeve me gojë<br>Vlerësim mes nxënësish | Teksti<br>Informacione<br>Skema |
| 33 | | **6. Bota e parasë** | Për të blerë mallra përdorim paranë si mjet këmbimi. | Parashikim me terma paraprakë<br>Veprimtari | | Teksti i nxënësit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 34 | **Test** | **3. Testim Tematika 3** | Kontrollohen njohuritë e marra për tematikën 3. | Vëzhgim<br>Shënime | Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm<br><br>Punë individuale | Burime vetjake të nxënësve<br><br>Tregu |
| 35 | **Veprimtari** | **1. Veprimtari: Jeta ime** | | Punë e drejtuar<br>Bisedë<br><br>Punë e pavarur | Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm<br><br>Vlerësim individual | Teksti<br>Informacione |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE (modele skematike)

***Shënim:*** Edhe pse planifikimet e mëposhtme ditore të orëve mësimore janë paraqitur për çdo orë, rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe nuk është detyrim që të realizohen të gjitha (të shtata kompetencat), por vetëm disa prej tyre. Paraqitja e plotë e tyre e pasqyruar në çdo orë mësimore, është bërë:

- për shkak të respektimit të formatit të një ore mësimore;
- me qëllim paraqitjen në të, të çdo detaji që do të ndihmonte në orientimin e punës së mësuesit;
- për të paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha pritshmëritë që mund të ketë secila prej orëve mësimore.

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika 1<br><br>Tema mësimore: Nevojat<br><br>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- rendit nevojat e individëve;<br>- evidenton llojet e nevojave në komunitet;<br>- vlerëson zgjidhjet e nevojave të komunitetit.</td><td colspan="2"><u>Zhvillimi i orës mësimore</u><br><u>Hapi i parë:</u> Të përkufizojë konceptin komunitet. Meqenëse është ora e parë, mësuesi/ja prezantohet duke treguar midis të tjerave, se është pjesë e komunitetit të mësuesve të shkollës. Më pas shkruan në dërrasën e zezë fjalën “komunitet” dhe nëpërmjet përvijimit të mendimit të nxënësve, mësuesi/ja plotëson kuptimin e kësaj fjale.<br><br><br><br><br>Punë individuale me shkrim. Duke pasur parasysh organizuesin grafik që ndërtuan nxënësit/et me mësuesen/in, u jepet detyrë të shkruajnë në fletore përkufizimin për konceptin komunitet. Ndiqen nxënësit/et gjatë punës dhe lexohen 2-3 përkufizime nga nxënës me nivele të ndryshme. Mësuesja/si shkruan në dërrasë përkufizimin përfundimtar (përkufizimi që është në tekstin mësimor).<br><u>Hapi i dytë</u>: 5-7’ Punë me grupe. Mësuesja/si për këtë temë paraqet para klasës imazhe nga grupe të ndryshme komunitetesh. Ndahet klasa në tri grupe dhe çdo grupi i jepet kjo detyrë:</td></tr>
</table>

**Fjalët kyçe:**
*nevoja bazë, nevoja sociale,*
*nevoja të komunitetit,*
*nevoja të veçanta,*
*identifikim i nevojave*

**Metoda dhe teknika:**
Hap pas hapi

*Grupi i parë:* Nga se dallohen komunitetet? (Komunitetet mund të dallohen nga: mosha e individëve që e përbëjnë atë, profesioni, madhësia, qëllimi, interesat, nevojat etj).
*Grupi i dytë:* Listoni komunitete të ndryshme, si: komuniteti i pallatit, i lagjes, i fshatit, i qytetit, i fëmijëve, i prindërve, i pensionistëve, komuniteti rom, i biznesmenëve, i mjekëve, i mësuesve, i nxënësve etj).
*Grupi i tretë*: Identifikoni komunitete ku bëni pjesë. Përgjigjet merren nga një përfaqësues grupi për secilën pyetje dhe diskutohen në klasë. Në komunitetin e pallatit, të lagjes, të qytetit/fshatit, të shkollës, klasës, vajzave apo djemve, grupeve artistike, grupeve sportive etj.
**Hapi i tretë:** 7' Diagrama piramidale. Mësuesja/si shkruan në dërrasë 4 lloje nevojash dhe u kërkon nxënësve t'i plotësojnë.

| | | | | | **Nevoja në komunitet** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **Piramida e nevojave të individit.** | | | |
| **Nevoja bazë (jetike)** | | **Nevoja sociale** | **Nevoja të përbashkëta** | | **Nevoja të veçanta** |
| Fiziologjike | Fizike | Familje | Shërbime | Infrastrukturë | Mjete lëvizëse speciale |
| Ushqim | Veshëmbathje | Dashuri | Siguri e jetës | Rrugë | Përshtatje e infrastrukturës (rampa) |
| Ujë | Strehim | Miqësi | Shëndetësi | Parqe | Sinjalistikë për të verbrit |
| | | Respekt/ Vlerësim | Arsim | Kënde lojërash | Edukim special |
| Oksigjen | | Zhvillim personal | Ligj | Furnizimi me ujë dhe energji-elektrike | Asistencë mjekësore dhe sociale |

**Hapi i katërt:** 10-15' Rast studimi, Lexim, diskutim, paraqitje, imazhe, CD nga përmbytjet. Diskutohet për përcaktimin e nevojave të familjes së personazhit që rrëfen pas përmbytjes dhe kush mund t'i plotësojë ato. Gjithashtu dhe për nevojat e komunitetit pas përmbytjes dhe plotësimin e tyre.
Nevojat e familjes së rrëfyesit mund të jenë për sigurimin e jetës dhe të shëndetit: evakuim i njerëzve dhe kafshëve shtëpiake, pompa për thithjen e ujit, pastrime dhe riparime, sigurimi i ushqimeve dhe ujit të pijshëm, veshmbathjeve, orendi shtëpiake. Dëmshpërblime për dëmet e shkaktuara në bujqësi, blegtori dhe orendi. Këto nevoja mund të plotësohen nga institucione dhe agjenci të qeverisë qendrore dhe asaj lokale. Në ndihmë të të dëmtuarve vijnë forcat

| | |
|---|---|
| | e policisë, ushtrisë dhe ato zjarrfikëse. Gjithashtu operacioni mbështetet dhe drejtohet nga "Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile". Përveç institucioneve publike, edhe komuniteti mund të marrë pjesë dhe të kontribuojë për të ndihmuar familjet në nevojë.<br>Nevojat e komunitetit pas përmbytjes përveç sa u tha më sipër, kanë të bëjnë edhe me riparimin e infrastrukturës së dëmtuar (rrugë, ura, kanalizime, rrjeti energjetik), si dhe rikthimin në funksionim të institucioneve dhe shërbimeve publike (arsim, mjekësi, polici etj). Këto nevoja plotësohen kryesisht nga shteti, por edhe me mbështetjen e organizatave dhe personave bamirës.<br><br>**Hapi i pestë:** Diskutim për rubrikën "Bëhemi pjesëmarrës".<br>Te rubrika "Bëhemi pjesëmarrës", ndahet klasa në dy pjesë dhe secila diskuton për nevojat e fëmijëve që jetojnë në kushte të vështira (fëmijët e braktisur, lypësit etj), ndërsa pjesa tjetër diskuton mbi nevojat e të moshuarve që kanë nevojë për kujdes të veçantë (të moshuarit pa familje etj). |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për eliminimin e diskriminimit dhe paragjykimit në një shoqëri të caktuar.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

| |
|---|
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**<br>**Nxënësi/ja:**<br>• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.<br>• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 7. |

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| Teksti i nxënësit,<br>Materiale nga interneti:<br>http://lexo.al/wp-content/uploads/2015/03/mjeket-QSUT1.gif<br>http://tv1-channel.tv/images/stories/2012_05/romet-3.png<br>http://gazetaedurresit.com/files/2012/11/Shkolla_Femijet_Emigrantet_01.jpg<br>http://www.gazetadita.al/wp-content/uploads/2013/12/pensioniste-pleq.jpg<br>http://opozita.com/wp-content/uploads/2013/11/komunitet.jpg<br>http://www.gazetalajm.com/wp-content/uploads/2015/02/permbytjet-ne-jug-te-shqiperise.jpg | - Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

Pika 2 te rubrika “Mbajmë qëndrim” te fq. 7.

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika 1<br><br>Tema mësimore: Shërbimet<br><br>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon për shërbimet në komunitetin ku bën pjesë;<br>- kategorizon llojet e shërbimeve;<br>- planifikon shërbime vullnetare në komunitet;<br>- shërben në komunitet.<br><br>Fjalët kyçe:<br>shërbime publike, shërbime jopublike<br><br>Metoda dhe teknika: Diskutim i lirë</td><td colspan="2"><u>Zhvillimi i orës mësimore</u><br>Kontrollohen detyrat e shtëpisë me temën: “Me ndryshimin e kushteve të jetesës, pse nevojat e nxënësve ndryshojnë me kalimin e viteve”. Nxënësi/ja sjell eksperienca dhe shembuj të ndryshëm. (Këtu mësuesja/si lidh mësimin e kaluar me atë të ditës). Ajo u shpjegon nxënësve se nevoja të ndryshme kërkojnë edhe shërbime të ndryshme publike apo jo publike. Për të nxitur diskutimin, mësuesja/si u drejton nxënësve pyetjet: (këto pyetje mund të shkruhen nga mësuesja/si në dërrasë të zezë)<br>- Përse ofrohen shërbime të ndryshme?<br>- Çfarë janë shërbimet?<br>- Për cilat lloje të shërbimeve ka nevojë komuniteti juaj?<br>- Si ofrohen këto lloje shërbimesh që kërkon individi dhe komuniteti?<br>-Kush mban përgjegjësi për ngritjen e shërbimeve kryesore publike?<br>- Kujt i përkasin shërbimet publike?<br>- Kush i ofron shërbimet jopublike?<br>Diskutohet rreth këtyre pyetjeve duke përfshirë sa më shumë nxënës.<br><br><u>Ndërtim njohurish:</u> 10’-15’. Punë me grupe ose në çift, muzeu shëtitës. Lexim-diskutim-listim.<br>Klasa ndahet në 4-grupe dhe secili grup pajiset me një fletë muri dhe lapustila. Dy grupe në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, evidentojnë nevojat në komunitetin e pallatit dhe nevojat në komunitetin e shkollës. Përkatësisht, secili prej këtyre grupeve bashkëpunon me grupin e ngritjes të shërbimeve për secilën nevojë. P.sh.: Nevoja për mjedis të pastër në pallat/shkollë, shërbimi, punë vullnetare nga banorët e pallatit apo nxënësit/et e shkollës për pastrimin e mjedisit, punësimi i një punëtoreje për shkallët e pallatit, organizimi i grupeve të pastërtisë të klasës dhe të shkollës etj. Nevoja për arsimim: shërbimi, ngritja e institucioneve parauniversitare të edukimit (çerdhe, kopsht, shkollë etj.). Tregohet kujdes që nxënësit/et të kategorizojnë shërbimet publike dhe ato jopublike.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Në fund, fletët e murit ngjiten nga secili grup dhe u jepet mundësi edhe grupeve të tjera për të shtuar nevoja dhe shërbime. Kjo veprimtari realizohet edhe nëpërmjet punës në çift. Njëri prej nxënësve përcakton llojin e shërbimit, ndërsa tjetri tregon çfarë ofron ky shërbim. Lexohet dhe bashkëbisedohet rreth punës së bërë nga nxënësit/et. Lexohet, diskutohet rasti i studimit në fq. 7 dhe pasi ndahet klasa në dy grupe, nxënësit/et të bëjnë listime. Grupi i parë: harton një listë të shërbimeve që ofron "Posta Shqiptare". Grupi i dytë: përgatit një listë me rregullat e shërbimit postar për dërgimin dhe marrjen e pakove: *dërgesa dhe komunikime informacionesh dhe pakosh të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, shërbime postare* (*dërgime letrash, kartolina, telegrame, pako etj.) pagesa të ndryshme*.<br>Mësuesja/si mund të organizojë edhe lojë me role, ku nxënësit/et ndahen në punonjës të postës dhe në individë apo persona përfaqësues të institucioneve private ose shtetërore, të cilët kanë nevojë për këtë lloj shërbimi.<br><br>**Përforcim: 10-15'** *Mund të punohet njëri prej aktiviteteve:*<br>- Rubrika "Mbajmë qëndrim" diskutim në grup.<br>- Punë individuale me fisha 1-2-3. Kjo fletë përmban:<br>"Përcakto: 1. shërbim që mund të bësh në familje; 2. shërbime që mund të bësh në shkollë dhe 3. në komunitetin ku banoni". |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për një shërbim sa më cilësor në komunitetin përreth.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

<table>
<tr><td colspan="2">Kompetenca qytetare<br>Nxënësi/ja:<br>1. zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;<br>2. shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia për një shërbim sa më cilësor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës<br>Nxënësi/ja:<br>• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.<br>• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 9.</td></tr>
<tr><td>Burimet<br>teksti mësimor, fletë muri, lapustila, fisha individuale 1-2-3 etj.</td><td>Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- Mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi:<br>Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).</td></tr>
<tr><td colspan="2">Detyrat dhe puna e pavarur:<br>Diskutoni me persona më të rritur dhe merrni informacion për llojet e shërbimeve që u nevojiten njerëzve me nevoja të veçanta. Silleni këtë informacion në klasë të pasqyruar në mënyra të ndryshme (foto, video etj).</td></tr>
</table>

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika 1<br><br>Tema mësimore: Institucionet<br><br>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon institucionet që shërbejnë në komunitet;</td><td colspan="2">Struktura e mësimit: ERR<br>Evokimi: (Stuhi mendimi)<br>1. Cilat janë institucionet që ofrojnë shërbime në komunitetin tuaj?<br>2. Çfarë lloje shërbimesh ofrojnë ato?<br>3. Cilat nga këto institucione frekuentoni më shpesh?<br>Realizimi i kuptimit (Kllaster)</td></tr>
</table>

- shpjegon llojet e shërbimeve që këto institucione ofrojnë në komunitet;
- argumenton qëndrimin e këtyre institucioneve në raste të veçanta.

**Fjalët kyçe:**
*institucione publike,*
*institucione private.*

**Metoda dhe teknika:** Stuhi mendimi




Reflektimi: (Harta e të pyeturit)




**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për respektimin e institucioneve shtetërore dhe publike.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët kanë nevojë për rolin e institucioneve shtetërore;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**
• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.

• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 11

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| teksti, interneti, botime të ndryshme. | - Mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**
Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
**Detyrë: Identifikoni institucionet dhe shërbimet që ato ofrojnë për të plotësuar nevojat e komunitetit tuaj. Kryeni këto veprime:**
a) Formohen grupet e punës.

b) Secili grup zgjedh një nevojë, plotëson tabelën për nevojën që ka zgjedhur.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Qytetari 6** | **Shkalla: III** | **Klasa: VI** |
|---|---|---|---|
| **Tematika 1**<br><br>**Tema mësimore:**<br>Përgjegjësitë e qeverisjes vendore | | **Evokimi (Parashikim me terma paraprake)**<br>Jepen termat: **strehim, shërbime sociale, arsim, shëndet, furnizim me ujë, argëtim, mjedis, transport publik.**<br>-Nxënësit/et do të formulojnë me shkrim, individualisht, nga një fjali për çdo term, por që të kenë lidhje midis tyre. | |

<table>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon organet e pushtetit vendor;<br>- shpjegon se cilat janë përgjegjësitë e qeverisjes vendore;<br>- argumenton detyrat kryesore të kryetarit të bashkisë.<br><br>Fjalët kyçe:<br>bashkia, këshilli bashkiak,<br>kryetari i bashkisë<br><br>Metoda dhe teknika:<br>ERR</td>
<td>- Mësuesi/ja shkruan në tabelë variantet më interesante të fjalive të krijuara nga nxënësit/et.<br>Realizimi i kuptimit:<br>- Duke pasur parasysh temën dhe objektivat, mësuesi/ja shpjegon për disa minuta thelbin e mësimit, duke u ndalur në çështjet kryesore.<br>- Në vijim, ndahet klasa në grupe me nga 4-6 nxënës dhe çdo grupi u shpërndahen pyetjet dhe harta e të pyeturit për temën “Përgjegjësitë e qeverisjes vendore”.<br>- Më pas ftohen nxënësit/et të lexojnë tekstin, burimet e tjera të informacionit dhe të nënvizojnë ato çështje që mund të shërbejnë si burim për përgjigjet e pyetjeve si më poshtë.<br>1. Ç’ngjashmëri dhe dallime mund të nxirrni nëse krahasoni rolin e qeverisjes vendore me rolin e pushtetit vendor?<br>2. Cili është roli i kryetarit të bashkisë?<br>3. Cili është roli i qytetarit përballë qeverisjes vendore?<br>4. A jeni të kënaqur me rolin e kryer nga qeverisja vendore në komunitetin tuaj?<br>-Nxënësit/et e çdo grupi, pasi diskutojnë përgjigjet e mundshme, japin vlerësime për to.<br>-Veprimtaria mbyllet me një diskutim të lirë, për t’i ndihmuar nxënësit/et t’i afrohen përgjigjeve që priten nga mësuesi/ja.<br>Reflektimi (Tabelë konceptesh)
<table>
<tr>
<td>Qeverisje vendore: nënkupton të drejtën e individëve të një komuniteti lokal për të qeverisur punën e tyre në mënyrë të pavarur.</td>
<td>Pushteti vendor: është organ që i merr vendimet në grup. Vendimet për qeverisjen vendore merren nga këshilli bashkiak.</td>
<td>Kryetari i Bashkisë: e ushtron detyrën e tij përmes institucioneve të qeverisjes vendore. Eshtë në shërbim të nevojave dhe të kërkesave të qytetarëve.</td>
</tr>
</table>
</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>Nxënësi/ja:<br><br>1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;<br><br>2. dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;<br><br>3. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;</td>
</tr>
</table>

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për përmirësimin e shërbimeve të qeverisjes vendore, lokale.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

*Nxënësi/ja:*

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**
• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.

• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 13.

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
| --- | --- |
| teksti, Interneti. | - Mjedisi<br><br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**
Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- **Detyrë**: Shkruani një letër për kryetarin e bashkisë ku t'i paraqisni një shqetësim të komunitetit tuaj.

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr>
<td colspan="2">
Tematika 1<br><br>
Tema mësimore:<br>Shërbimet që ofrohen në komunitet<br><br>
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>
Nxënësi/ja:<br>
- njeh disa nga shërbimet që ofrohen në komunitet;<br>
- shpjegon rolin e institucioneve që plotësojnë nevojat e komunitetit ku banon;<br>
- arsyeton se përpara ligjit të gjithë qytetarët janë të barabartë.<br><br>
Fjalët kyçe:<br>
shërbimi i punësimit,<br>punëkërkues,<br>punëdhënës,<br>programe sociale të strehimit,<br>shërbimi policor në komunitet.<br><br>
Metoda dhe teknika: ERR
</td>
<td colspan="2">
Evokimi (Di, Dua të di, Mësoj)
<table>
<tr><th>Di</th><th>Dua të di</th><th>Mësoj</th></tr>
<tr><td>Qytetarët përfitojnë shërbime të cilat përmirësojnë jetën e tyre në komunitet</td><td>Se cilat janë shërbimet kryesore që ofrohen në komunitetin tim.</td><td>Rolin që luan Shërbimi Kombëtar i Punësimit, rolin e programeve sociale të strehimit, roli i policisë në komunitet.</td></tr>
</table>
Realizimi i kuptimit<br>
Udhëzon nxënësit/et të lexojë tekstin duke mbajtur shënime.<br>
-Gjatë leximit të një pjese, nxënësit/et duhet të gjejnë një ose disa pjesë, që sipas tyre janë interesante dhe ia vlejnë të diskutohen.<br>
-Pjesa e zgjedhur shkruhet në një skedar bashkë me numrin e faqes prej së cilës është shkëputur.<br>
-Në anën e pasme të skedës shkruhet një koment. Nxënësit/et mund ta përpunojnë apo të zgjedhin çfarë të duan.<br>
-Një nxënës/se lexon me zë të lartë fragmentin e zgjedhur. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të tjerë që kanë zgjedhur këtë fragment të bëjnë komentet përkatëse. Duhet bërë kujdes që diskutimi të përqendrohet atje ku duhet. Mësuesi/ja mund të orientojë nxënësit/et.<br>
-Për ta mbyllur diskutimin, mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë me zë të lartë komentet e tyre. Ky është sekreti. Diskutimi përfundon këtu.<br>
-Mësuesi/ja fton një nxënës/e tjetër që të lexojë pjesën e tij /saj të preferuar dhe e fillon diskutimin nga e para.<br>
Reflektimi (INSERT) (√,¯,+, ?), informacion i shenjëzuar në tabelën “Insert”.
<table>
<tr><th>√</th><th>-</th><th>+</th><th>?</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>
Diskutim i lirë:<br>
-Merren mendimet e nxënësve të shënuara në tabelën ‘’INSERT”.<br>
-Mendimet që përbëjnë shumicën, shkruhen ne tabelë.<br>
-Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje e problemeve.
</td>
</tr>
</table>

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**
**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për përfitimin e shërbimeve pa dallime race, etnie, gjinie në një komunitet.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;

***Kompetenca qytetare***

*Nxënësi/ja:*

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**
• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.

• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 15.

| Burimet | Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| teksti, Interneti. | - Mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**
Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:
pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- **Detyrë**: Ndahuni në tre grupe dhe përgatisni nga një fletëpalosje për secilin nga shërbimet: të punësimit, të strehimit, të policisë.

<table>
<tr><th>Fusha:<br>Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda:<br>Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">**Tematika 1**<br><br>**Tema mësimore:**<br>Shërbime për grupet në nevojë.<br><br>**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- përcakton termin shërbim;<br>- shpjegon se cilat janë shërbimet për grupet në nevojë;<br>- argumenton rolin e qytetarëve dhe institucioneve shtetërore në lidhje me sigurimin e këtyre shërbimeve.<br><br>**Fjalët kyçe:**<br>*njeri me aftësi të kufizuara, shërbime të specializuara, alfabeti Brail, gjuha e shenjave*<br><br>**Metoda dhe teknika:**<br>**ERR**</td><td colspan="2">**Evokimi (*Brainstroming)***<br>Fillimisht nxënësit/et lexojnë tekstin dhe rastin studimor, duke kuptuar në këtë mënyrë kontributin e shtetit dhe të institucioneve përkatëse. Mësuesi/ja përmbledh faktet dhe idetë që u lindin nxënësve pas leximit të materialit që panë e lexuan dhe krijon një *brainstorming* me temë “rëndësinë e shërbimeve për grupet në nevojë”.<br><br>**Realizimi i kuptimit (Tryeza rrethore)**<br>Ndahet klasa në dy grupe të mëdha, që përbëjnë dy tryeza rrethore të veçanta.<br>• Çdo tryezë do të punojë për të dalluar llojet e ndryshme të shërbimeve në komunitet për grupet në nevojë.<br>• Duke kombinuar elementet e zbulimit me teknikat e nxitjes dhe të provës, mësuesi/ja shkruan në tabelë një sërë pyetjesh, që bazohen në kriteret themelore për dallimin e shërbimeve kryesore për grupet në nevojë.<br>1. Cilat janë disa nga të drejtat e grupeve në nevojë?<br>2. Për çfarë lloje shërbimesh kanë nevojë këto grupe?<br>3. Çfarë roli luajnë institucionet shtetërore në komunitet?<br>4. Cilat janë disa nga shërbimet që ofrohen në komunitetin tuaj ndaj grupeve në nevojë?<br>5. Cilat shërbime mungojnë në komunitetin tuaj?<br>6. A mendoni se është e drejtë situata e krijuar në komunitetin tuaj për grupet në nevojë?</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | **Nxënësit/et veprojnë në këtë mënyrë:**<br>**Në tryezën e parë:**<br>• **Nxënësi/ja i/e parë** shkruan në një fletë me format të madh përgjigjen e pyetjes së parë për të drejtat e grupeve në nevojë.<br>• **Nxënësi/ja i/e dytë** shkruan përgjigjen e pyetjes së dytë.<br>• **Nxënësi/ja i/e tretë** shkruan përgjigjen e pyetjes së tretë.<br>• **Nxënësi/ja i/e katërt** shkruan përgjigjen e pyetjes së katërt.<br>• **Nxënësi/ja i/e pestë** shkruan përgjigjen e pyetjes së pestë.<br>• **Nxënësi/ja i/e gjashtë** shkruan përgjigjen e pyetjes së gjashtë.<br>*.. e kështu me radhë rifillon puna me nxënësin e shtatë.*<br>• **Nxënësi/ja i/e shtatë** në vijim të përgjigjes së nxënësit të parë, shkruan si e mendon përgjigjen e pyetjes së parë.<br>• **Nxënësi/ja i/e tetë** shkruan përgjigjen e pyetjes së dytë.<br>... e *kështu deri te nxënësi i fundit i tryezës së parë.*<br>**Në tryezën e dytë**<br>• Nxënësit/et ndjekin të njëjtën procedurë si në tryezën e parë, por për të dalluar llojin e shërbimeve për të cilat kanë nevoje grupet.<br>• Në fund bëhet diskutimi dhe vlerësimi i mendimeve të shprehura për secilën nga çështjet.<br>• Përfaqësuesit e tryezave rrethore paraqesin para klasës idetë e përmbledhura e të përpunuara.<br><br>**Reflektimi (Turi i galerisë)**<br>Turi i galerisë është një teknikë, gjatë së cilës janë ekspozuar punimet e nxënësve nëpër muret e klasës. Nxënësit/et bëjnë një udhëtim me to, si në galeri.<br><br>**Mënyra e zbatimit**<br>Përmbledhjet e shkruara dallueshëm nga tryeza e parë për dallimin e të drejtave të grupeve në nevojë dhe llojeve te shërbimeve për këto grupe afishohen në mure.<br>• Nxënësit/et lexojnë, diskutojnë, bëjnë komente rreth përgjigjeve, identifikojnë dhe krahasojnë.<br>Në fletët e paraqitura nxënësit/et mund të bëjnë edhe shtesa, komente, saktësime etj.<br>• Mësuesi/ja ndjek punimet e nxënësve, tregon ndonjë kureshtje ose bën ndonjë shpjegim specifik. |

| |
|---|
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe** |
| **Nxënësi/ja:** |
| **1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; |

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për cilësinë e shërbimeve për grupet në nevojë.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia dhe bashkëpunimi reciprok.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**

• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.

• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 17

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| teksti, Interneti. | - Mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

**Detyrë: Identifikoni shërbime që ofrohen ose që mungojnë në komunitetin tuaj për personat me aftësi të kufizuara. Diskutoni për ndikimin që kanë këto shërbime në jetën e qytetarëve.**

# Tematika 1
**Projekt (ora e parë)**

**Lënda**: Qytetari
**Klasa**: VI

**Tema**: **Si të realizojmë një vlerësim të nevojave për komunitetin e të moshuarve**

**Qëllimi**: Formimi te nxënësit i aftësive dhe i shprehive të nevojshme për të qenë të suksesshëm në një punë të thjeshtë kërkimore-shkencore.

Në përfundim të projektit nxënësit/et:
• kryejnë vëzhgime të thjeshta në terren;
• zbulojnë atë që është thelbësore për një dukuri;
• bëjnë dallimin ndërmjet karakteristikave të llojit dhe karakteristikave të veçanta të dukurisë apo objektit në vëzhgim;
• grumbullojnë informacionin e nevojshëm, sistemojnë, analizojnë dhe vlerësojnë atë;
• arrijnë në përfundime dhe mbajnë qëndrime për zgjidhjen e problemit;
• mbrojnë opinionin e vet dhe vlerësojnë opinionet e komunitetit të të moshuarve.

**Përparësitë metodologjike të projektit kërkimor:**
Të mësuarit e sotëm ka në qendër nxënësin/en dhe në këtë proces mësuesi/ja:
• udhëheq të mësuarit dhe u ofron nxënësve rrugën për kërkimin e pavarur të informacionit;
• në vend të zgjidhjeve të gatshme, u kërkon nxënësve mundësi për të gjetur shumëllojshmëri zgjidhjesh për të njëjtin problem.

**Vlerat**
• Në aspektin e mësimdhënies dhe të të nxënit.
• Në edukimin e nxënësve me frymën demokratike për zgjidhjen eproblemeve.
• Në aftësitë që përfitojnë nxënësit.

**Teknikat që do të përdoren**
• Anketimi, intervista, pyetësori, vëzhgimi, ekskursioni.
• Ndërtimi i dosjeve dokumentare dhe proceduriale, si dhe i posterave të thjeshtë.

Sistemimi dhe ekspozimi në një vend të klasës apo shkollës i arritjeve më me vlerë të projektit me temë: “**Vlerësimi i nevojave për komunitetin e të moshuarve”.**
**Drejtimi i projektit**
• Mësuesit e lëndës, një përfaqësues i komunitetit të shkollës, një specialist i zonës për intervistimin e komunitetit të të moshuarve.

**Niveli i nxënësve**
• Klasat

**Bashkëpunimet e mundshme**
• Mësues të lëndëve të tjera,
• Specialistë të sferave të ndryshme.

**Organizimi i nxënësve**
• Në grupe me nga katër anëtarë secili.
**Hapat (fazat) e planifikuara**
• Ideja e projektit kërkimor sugjerohet nga mësuesi i lëndës
• **Ndarja e klasës në grupe**
Zgjedhja e përgjegjësit të grupit të punës dhe detyrat e çdo anëtari sipas prirjeve vetjake.
Takimi i grupeve, miratimi i platformës së punës, qëllimit dhe objektivave.
• Hartimi i dosjeve të punës në grup, mbushja e tyre me informacionin e nevojshëm sipas tematikës së çdo grupi; mbështetja faktike e tyre në objekte relike, sipas kritereve të përcaktuara.
• Vlerësimi i rezultateve të arritura nga çdo grup dhe ballafaqimi i tyre në klasë para mësuesit.
• Mbrojtja e rezultateve të arritura dhe vlerësimi i opinioneve dhe fakteve të sjella nga grupet e tjera.

-Planifikimi i këtij projekti dhe konkretisht i kësaj teme, vjen si rezultat i zhvillimit të temave mësimore që trajtojnë temat dhe problematikat e shërbimeve në komunitet, institucioneve përgjegjëse (vendore dhe lokale).

**Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të fazës së parë janë:**

**Përshkruhen:**
- aftësitë, nevojat, problemet, kushtet specifike të të moshuarve në komunitetin tuaj;
- përgjegjësitë sociale dhe ndjenja e respektit për individët në nevojë;
- mbajtja e një qëndrimi dashamirës dhe përkujdesjes ndaj kësaj kategorie;
- vlerat dhe qëndrimet pozitive për njerëzit në nevojë;
- shprehi komunikimi, shprehi të punës në grup, të organizimit të punës, të marrjes së vendimeve, të bashkëpunimit.

Për të qëndruar në fazën e parë, hapat që duhet të ndërmarrim janë:
- vlerësimi i nevojave të të moshuarve dhe ndihma e institucioneve përkatëse.
- hartimi i programeve për t'i ardhur në ndihmë të moshuarve;
- përfshirja e disa personave të specializuar siç janë punonjësit e qeverisjes lokale, studentë, nxënës të shkollave të mesme, vullnetarë dhe stafi i organizimit të veprimtarive jo publike në bashkëpunim me nxënësit;
- përcaktohet grupi i të moshuarve që do të jenë pjesë e këtij procesi.
- përgatitja e pyetjeve të intervistës për të moshuarit (me gjuhë të thjeshtë dhe të qartë) - mënyra (ballë për ballë ose me telefon);
- intervistimi dhe marrja e opinioneve dhe mendimeve në lidhje me zhvillimin e shërbimeve në komunitet.

- kontaktimi i tyre në shtëpitë e të moshuarve, në parqe apo në rrugë;
- cilësia e shërbimeve;
- çfarë lloje shërbimesh janë të nevojshme dhe shumë specifike;
- opinionet që ata mund të shprehin do të përdoren për të ndërtuar programe, të cilat do të synojnë ndryshimin e kushteve të tyre të jetesës, përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve.

**Shënim:** Prezantimi i projektit do të bëhet në orën e dytë të planifikuar të projektit. Deri në fazën e prezantimit, gjatë orëve të ndryshme mësimore (mqs çështjet që trajtohen në projekt janë çështje të disa temave mësimore), mësuesja/mësuesi mund të programojë pak kohë për të diskutuar me nxënësit rreth punës që do të kryejnë për realizimin e projektit.
**Diskutohet për:**
(Burimet e informacionit, vështirësitë e mundshme dhe rolin e bashkëpunimit si grup.)

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Qytetari 6** | **Shkalla: III** | **Klasa: VI** |
|---|---|---|---|
| **Tematika 1**<br><br>**Tema mësimore:**<br>Vullnetarizmi<br><br>**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- përkufizon se çfarë do të thotë ofrimi i shërbimeve vullnetare në komunitet;<br>- shpjegon vullnetarizmin si element i humanizmit njerëzor;<br>- argumenton dobinë e punës vullnetare. | | **Evokimi: (*Mendo/ Puno në dyshe / Shkëmbe)***<br>• Nxënësit/et lexojnë tekstin për temën e “Shërbimeve vullnetare në komunitet”.<br>• Nxënësi/ja i/e parë, në çift sipas zgjedhjes, studion, nënvijëzon në tekst dhe mban shënime për llojet e vullnetarizmit dhe i dyti pjesëmarrjen e njerëzve në punën vullnetare.<br>Më pas ata mendojnë, punojnë në çift, shkëmbejnë mendime, identifikojnë dhe listojnë veçoritë e përbashkëta të vullnetarizmit dhe punës vullnetare.<br><br>**Realizimi i kuptimi**t (ditari me dy pjesë)<br>Zgjidhni dhe komentoni një nga citatet që ju tërheq më shumë:<br>**Citati**<br>•Puna vullnetare dhe rëndësia e saj<br>**Komenti i nxënësit/es**<br>____________________<br>____________________<br>____________________<br>____________________ | |

**Fjalët kyçe:**
*vullnetarizëm, vullnetar.*

**Metoda dhe teknika:**
ERR

**Citati**
•Përhapja e vullnetarizmit në botë
**Komenti i nxënësit/es**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**Reflektimi** ***(Diagrami i "Venit")***

**Vullnetarizmi** ⟶ **Puna vullnetare**



| Tiparet dalluese | Veçoritë e përbashkëta | Tiparet dalluese |
|---|---|---|
| | | |

**Vlerësimi, komente, sugjerime.**

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për dallimin e një shpirti vullnetar, duke u bazuar në dëshirat dhe vullnetin e gjithsecilit.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë.

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia dhe aktet vullnetare.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**
• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.

• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 21

**Burimet**
teksti, Interneti.

**Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**
- Shkencat shoqërore dhe mjedisi

- Gjuha dhe komunikimi

**Vlerësimi:**
Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
**Detyrë: Përgatit një ese me temë: "Puna ime vullnetare në komunitet".**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Qytetari 6** | **Shkalla: III** | **Klasa: VI** |
|---|---|---|---|

**Tematika 1**

**Tema mësimore:**
Vlerësimi i nevojave dhe i burimeve.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:**
**Nxënësi/ja:**
- identifikon nevojat që kanë individët, grupet ose komuniteti në tërësi;
- analizon mundësitë për të plotësuar nevojat dhe burimet në komunitet;

**Evokimi: (Tabelë konceptesh)**

| Vlerësim i nevojave | Vlerësim i burimeve | Plan i vlerësimit të nevojave | Intervista | Anketa |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**Realizim i kuptimit (Teknika e pyetjeve)**
Mësuesi/ja për disa minuta, duke pasur parasysh hartën e të pyeturit, shpjegon thelbin e mësimit, duke u ndalur posaçërisht në kuptimin e fjalëve kyçe:

<table>
<tr>
<td>- diskuton mbi institucionet e specializuara në plotësimin e nevojave të komunitetit.<br><br>Fjalët kyçe:<br>vlerësim i nevojave, vlerësim i burimeve, plani i vlerësimit të nevojave, anketa<br><br>Metoda dhe teknika:<br>ERR</td>
<td>Në vijim ai/ajo e ndan klasën në grupe (4-6 nxënës) dhe shpërndan në çdo grup hartën e të pyeturit me temën: “Vlerësimi i nevojave dhe i burimeve.”<br>Më pas i fton nxënësit/et të lexojnë tekstin, burimet e tjera të informacionit dhe të nënvizojnë ato çështje që mund të shërbejnë si burim për përgjigjet e pyetjeve të shënuara në tabela. Nxënësit/et e çdo grupi, pasi diskutojnë përgjigjet e mundshme të pyetjeve, i vlerësojnë dhe i shënojnë ato në fletore, duke ruajtur radhën logjike sipas drejtimit të shigjetave në hartën e të pyeturit për temën: “Vlerësimi i nevojave dhe i burimeve”.<br><br><br><br><br>Reflektimi (Rrjeti i diskutimit)<br>-Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen binare me temë:<br><br>Si mund t’i vlerësojmë nevojat dhe burimet tona në komunitet<br>____________________ ____________________<br><br>Pro<br>____________________ ____________________<br><br>Kundër<br>____________________ ____________________</td>
</tr>
<tr>
<td></td>
<td>Vlerësimi, komente, sugjerime</td>
</tr>
</table>

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për plotësimin e nevojave dhe burimeve në komunitetin ku jeton.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë.

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e plotësimit të nevojave dhe të burimeve në komunitetin ku bën pjesë.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

**Nxënësi/ja:**

- Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.
- Dallon mesazhin e pjesës në faqen 23

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| teksti, Interneti. | - Mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

**Detyrë: Bëni një listë me pesë nevojat që kanë përparësi për t'u plotësuar për komunitetin tuaj lokal dhe argumentoni përparësinë e tyre.**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari 6 | Shkalla: III | Klasa: VI |
|---|---|---|---|

**Tematika 1**

**Tema mësimore:** Cilësia e shërbimeve

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:**
**Nxënësi/ja:**
- përcakton cilësinë e shërbimeve të ndryshme në komunitet;
- shpjegon të drejtat e qytetarëve për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me këto shërbime;
- argumenton rolin e institucioneve, organizatave dhe shtetit në lidhje me realizimin e intervistave, pyetësorëve, formularëve rreth vlerësimit të cilësisë së shërbimeve.

**Fjalët kyçe:**
*vlerësimi i cilësisë së shërbimeve, pyetësori, intervista*

**Metoda dhe teknika:** ERR

**Evokimi (Insert)**
Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin duke mbajtur shënime me anë të shenjave të teknikës së INSERT-it: √, +, -, ?.
Leximi i tekstit bëhet duke vendosur shenjat: √, +, -, ?. Nënvizimet e bëra në libër hidhen në tabelën e INSERT-it.

| √ | + | – | ? |
|---|---|---|---|
| | | | |

Realizimi i kuptimit (kllaster)




**Reflektimi (Shkrim i lirë)**

**- Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve në komunitetin tuaj?**

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për përmirësimin e shërbimeve në një shoqëri të caktuar.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë.

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia dhe dëshira e plotësimit dhe respektimit të shërbimeve sociale dhe cilësisë së tyre.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**
• Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.

• Dallon mesazhin e pjesës në faqen 25

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| teksti, Interneti. | - Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br><br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

**Detyrë: Plotësimi i tabelës në rubrikën "Bëhemi pjesëmarrës"**

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">
Tematika 1<br><br>
Tema mësimore:<br>
Pjesëmarrja në jetën e komunitetit.<br><br>
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>
Nxënësi/ja:<br>
- identifikon rolin e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve të komunitetit;<br>
- shpjegon përgjegjësitë dhe detyrat e anëtarëve të komunitetit;<br>
- arsyeton mbi zgjidhjen e problematikave në komunitetin tonë.<br><br>
Fjalët kyçe:<br>
jeta e komunitetit, pjesëmarrje, angazhim<br><br>
Metoda dhe teknika:<br>
ERR
</td><td colspan="2">
Evokimi (Brainstorming)<br>
Pasi shkruan në tabelë temën e mësimit, mësuesi/ja krijon një brainstorming. Ai/ajo iu kërkon nxënësve të paraqesin një listë idesh dhe faktesh për rolin dhe angazhimin e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve të komunitetit të tyre. Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë.<br>

<br>
Realizimi i kuptimit (Kubimi)<br><br>
Nxënësit/et ndahen në dy grupe (4-6 nxënës) dhe u jepet detyrë të lexojnë temën: “Pjesëmarrja në jetën e komunitetit”.<br>
Secilit grup i është dhënë një kub, në faqet e të cilit janë shkruar foljet: përshkruani, shoqëroni, analizoni, zbatoni. Për secilin nga këto veprime, mësuesi/ja ka përgatitur pyetje dhe kërkesa për demonstrime, të cilat i shkruan në tabelë. Nxënësit/et e lexojnë me kujdes tekstin për të gjetur përgjigjet e pyetjeve, sipas variantit të supozuar më poshtë:<br>
Përshkruani:<br>
- Cili është roli i qytetarit në komunitet?<br>
| **Tematika 2**<br><br>**Tema mësimore:**<br>Konfliktet me bazë kulturore<br><br>**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon termin konflikte kulturore;<br>- shpjegon dallimet midis termave tolerancë, kompromis, vetëmbrojtje;<br>- diskuton mbi arritjet e një debati pozitiv.<br><br>**Fjalët kyçe:**<br>*konflikte kulturore,*<br>*tolerancë,*<br>*kompromis,*<br>*vetëpërmbajtje,*<br>*debat pozitiv*<br><br>**Metoda dhe teknika:**<br>**ERR** | | **Evokimi: (Brainstorming)**<br>Pasi nxënësit/et kanë lexuar paraprakisht tekstin dhe copëzat e leximit, mësuesi (për të përmbledhur faktet dhe sidomos idetë, që nxënësve u lindin për shkak të nxitjes që u bëri materiali), krijon një *Brainstorming* me temë: “Zgjidhja e konflikteve në mënyrë qytetare është detyrë apo kompromis?”.<br><br>**Reflektimi (Tryeza rrethore)**<br><br>Ndahet klasa në dy grupe të mëdha, që përbëjnë dy tryeza rrethore të veçanta.<br>• Çdo tryezë do të punojë për të zbuluar të fshehtat e një konflikti kulturor nga tryeza tjetër mbi metodat e zgjidhjes se një konflikti.<br>• Mësuesi, duke kombinuar elementet e zbulimit me teknikat e nxitjes dhe të provës, shkruan në tabelë një sërë pyetjesh, që bazohen në kriteret themelore për zbulimin e të fshehtave të një konflikti kulturor si më poshtë:<br>-Cfarë kuptojmë me termin konflikt kulturor?<br>-Ku qëndron dallimi mes termit tolerancë dhe kompromis?<br>-Çfarë kuptojmë me termin vetëpërmbajtje?<br>**-**Si mund të arrijmë në një debat pozitiv dhe konstruktiv?<br>-Pse themi se njerëzit janë të ndryshëm?<br>-Si arrihet zgjidhja e konflikteve mes qytetarëve?<br><br>Nxënësit veprojnë në këtë mënyrë:<br>**Në tryezën e parë:**<br>• **Nxënësi i parë** shkruan në një fletë me format më të madh përgjigjen e pyetjes së parë për termin konflikt kulturor.<br>• **Nxënësi i dytë** shkruan përgjigjen e pyetjes së dytë.<br>• **Nxënësi i tretë** shkruan përgjigjen e pyetjes së tretë.<br>• **Nxënësi i katërt** shkruan përgjigjen e pyetjes së katërt.<br>• **Nxënësi i pestë** shkruan përgjigjen e pyetjes së pestë.<br>• **Nxënësi i gjashtë** shkruan përgjigjen e pyetjes së gjashtë. | |

| | |
|---|---|
| | *e kështu me radhë rifillon cirkuiti me nxënësin e shtatë.*<br>• **Nxënësi i shtatë** në vijim të përgjigjes së nxënësit të parë, shkruan si e mendon përgjigjen e pyetjes së parë.<br>• **Nxënësi i tetë** shkruan përgjigjen e pyetjes së dytë.<br>... e *kështu deri tek nxënësi i fundit i tryezës së parë.*<br>**Në tryezën e dytë**<br>• Nxënësit ndjekin të njëjtën procedurë si në tryezën e parë, por për të zbuluar metodat e zgjidhjes së një konflikti.<br>• Në fund bëhet diskutimi dhe vlerësimi i mendimeve të shprehura për secilën nga çështjet.<br>• Përfaqësuesit e tryezave rrethore paraqesin para klasës idetë e përmbledhura e të përpunuara.<br><br>**Reflektimi (Turi i galerisë)**<br>Përmbledhjet e shkruara dallueshëm nga tryeza e parë për të zbuluar të fshehtat e një konflikti kulturor nga tryeza tjetër mbi metodat e zgjidhjes së një konflikti afishohen në mure.<br>• Nxënësit lexojnë, diskutojnë, bëjnë komente rreth përgjigjeve, identifikojnë dhe krahasojnë të veçantat e zbuluara midis konflikteve kulturore dhe mënyrës së zgjidhjes së tyre.<br>• Në fletët e paraqitura nxënësit mund të bëjnë edhe shtesa, komente, saktësime etj.<br>• Mësuesi ndjek punimet e nxënësve, tregon ndonjë kureshtje ose bën ndonjë shpjegim specifik. |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për eliminimin e diskriminimit dhe paragjykimit në një shoqeri të caktuar

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**

- Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.
- Dallon mesazhin e pjesës në faqen 49

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| teksti, Interneti. | **-** Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br>**-** Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

**Detyrë: Çfarë do të sugjeronit për banorët e pallatit, në mënyrë që midis tyre të ketë mirëkuptim dhe bashkëjetesë të shëndetshme?**

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika 2<br><br>Tema mësimore: Të mos diskriminojmë<br><br>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- përcakton ngjarjet nisur nga elementet e dhëna;<br>- dallon mesazhin e pjesës së dhënë;<br>- portretizon personazhet, duke u ndalur në vlerat që përcjellnin.<br><br>Fjalët kyçe: Paragjykim, diskriminim.<br><br>Metoda dhe teknika: Parashikimi me terma paraprakë, harta e të pyeturit dhe rrjeti i diskutimit.</td><td colspan="2">Parashikim me terma paraprakë: Jepen termat: Diskriminim, Paragjykim.<br><br>Nxënësit do të formulojnë individualisht nga një fjali për çdo term, por që kanë lidhje midis tyre.<br>• Variantet më interesante të fjalive të krijuara shkruhen në tabelë.<br><br>Harta e të pyeturit. Mësuesi pasi bën ndarjen e klasës në grupe fillestare (4-6 veta) i ofron çdo grupi “Hartën e të pyeturit”.<br>• Në vijim fton nxënësit të shkruajnë në fletore pyetjet dhe përgjigjet korresponduese të tyre.<br><br><br><br><br>Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi shkruan në dërrasën e zezë pyetjen binare, me temë:<br>- Identifikoni mesazhet që nxisin dhe parandalojnë paragjykimet në këtë bisedë (Referencë rastit studimor në fq 51).<br>Në fillim, nxënësit studiojnë tekstin, vizojnë dhe mbajnë shënime individuale për të dhënë argumente “Pro” ose “Kundër” pyetjes binare.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | • Në vijim, vetëpozicionohen sipas qëndrimeve të zgjedhura në një nga grupet e mëdha "Pro" ose "Kundër".<br>• Nxënësit e grupeve kundërshtare i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, japin përgjigje dhe argumentojnë në favor të opinionit të tyre.<br>• Mësuesi e drejton debatin midis grupeve, duke mbajtur një qëndrim asnjanës.<br>• Kur shterojnë pyetjet dhe diskutimet midis grupeve, mësuesi ndërhyn për t'i zgjeruar idetë e nxënësve me fakte të reja dhe me pyetje nxitëse "Pro" ose "Kundër".<br>• Në fund, pa bërë përkufizime, diskutimi lihet i hapur.<br>**Pro**<br>**Kundër** |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

***Diskriminimin, paragjykimin***

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për eliminimin e diskriminimit dhe paragjykimit në një shoqëri të caktuar.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**
**Nxënësi/ja:**
- Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.
- Dallon mesazhin e pjesës në faqen 51.

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| - Teksti i nxënësit,<br>- materiale nga interneti,<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. | **-** Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br>**-** Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**
Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
Krijoni një tregim të shkurtër, i cili të përcjellë mesazhin: **"Njerëzit janë të ndryshëm, por të barabartë."**

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika 2<br><br>Tema mësimore: Zgjidhja e konfliktit<br><br>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon termin konflikt;<br>- shpjegon mënyrat e zgjidhjes së konfliktit;<br>- diskuton mbi dallimet e termave: mirëkuptim dhe paqe.</td><td colspan="2">Struktura e mësimit: ERR<br>Evokimi: (Tabelë konceptesh)<br>
</td></tr>
</table>

**Fjalët kyçe:**
*zgjidhje konflikti, aspekte pozitive*

**Metoda dhe teknika:**
Parashikimi me terma paraprakë, harta e të pyeturit dhe rrjeti i diskutimit.

**Realizimi i kuptimit (Diagrami i Venit)**




| Tiparet dalluese | Veçoritë e përbashkëta | Tiparet dalluese |
|---|---|---|
| • Njerëzit përdorin mënyra të ndryshme për zgjidhje të konfliktit.<br>• Krahasimi ndodh me sjelljet e disa kafshëve.<br>• Sjellja e peshkaqenit, aftësi për të pranuar konfliktin.<br>• Sjellja e dhelprës nxit marrëveshje dhe mirëkuptim.<br>• Sjellja e bufit sjell bashkëpunim dhe ndershmëri. | • Zgjidhja e konfliktit të çon në dy rrugë të rëndësishme.<br>• Mirëkuptim.<br>• Paqe. | • Sjelljet e breshkës nënkuptojnë shmangie të konfliktit.<br>• Sjelljet e arushit, aftësia për t'u përshtatur në situata të ndryshme. |

**Reflektimi (Ditari me dy pjesë)**



**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për eleminimin e diskriminimit dhe paragjykimit në një shoqeri të caktuar.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit të mendimeve të gjithësecilit, pa dallime racore, fetare, etnike dhe kulturore.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

**Nxënësi/ja:**

- Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.
- Dallon mesazhin e pjesës në faqen 53.

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| - Teksti i nxënësit,<br>- materiale nga interneti,<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. | - Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
**Detyrë: Vlerësoni reagimet e çdonjërit prej nxënësve dhe krahasojini ato me modelet e sjelljeve për zgjidhje të konfliktit (Do t'i referoheni rastit studimor në fq. 53).**

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">

**Tematika 2**

**Tema mësimore:** Dita e tolerancës

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:**
**Nxënësi/ja:**
- përcakton ngjarjet nisur nga elementet e dhëna;
- dallon mesazhin e pjesës së dhënë;
- portretizon personazhet duke u ndalur në vlerat që përcjellin.

**Fjalët kyçe:** *Respekt reciprok, bashkëpunim.*

**Metoda dhe teknika:** Parashikimi me terma paraprakë, Kllaster, Shkrim i lirë.

</td><td colspan="2">

**Parashikim me terma paraprakë: Jepen termat: Respekt reciprok, bashkëpunim.**
Nxënësit do të formulojnë individualisht nga një fjali për çdo term, por që kanë lidhje midis tyre.
• Variantet më interesante të fjalive të krijuara shkruhen në tabelë.
**Kllaster:**




**Shkrim i lirë: Përshkruani se si ndihen shokët e Gentit të cilët nuk do të ftohen në ditëlindjen e tij (referuar rastit studimor në fq 55.)**

</td></tr>
</table>

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

***Respekt reciprok dhe bashkëpunim***

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të bashkëpunimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për bashkëpunimin dhe respektimin reciprok ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë ku toleranca duhet të mbizotërojë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron bashkëpunimi, respekti reciprok, i cili të çon në shmangie të konflikteve.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

**Nxënësi/ja:**

- Parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna.
- Dallon mesazhin e pjesës në faqen 56.

| **Burimet** | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| - Teksti i nxënësit,<br>- materiale nga interneti,<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. | - Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
Krijoni një tregim të shkurtër, i cili të përcjellë mesazhin: Bashkëpunimi midis njerëzve është i rëndësishëm dhe mënjanon konfliktet.

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Qytetari 6</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Përsëritje<br><br>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon termin “shërbim për komunitetin”;<br>- shpjegon me përparësi nevojat që ka komuniteti juaj<br>- diskuton mbi elementët karakteristike të kulturës suaj</td><td colspan="2">Struktura e mësimit: ERR<br>Evokimi: (Harta e të pyeturit)<br><br><br><br>Realizimi i Kuptimit (Ditari me tre pjesë)</td></tr>
</table>




**Reflektimi (Shkrim i lirë) Shkruani një ese: "Jam krenar që jam shqiptar".**

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

***Respekt reciprok dhe bashkëpunim.***

**Nxënësi/ja:**

**1.** shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të bashkëpunimit;

**2.** dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;

**3.** lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;

**4.** shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi/ja:** shpreh mendimin për bashkëpunimin dhe respektimin reciprok ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi/ja:** zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

***Kompetenca qytetare***

***Nxënësi/ja:***

**1.** zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë ku toleranca duhet të mbizotërojë;

**2.** shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron bashkëpunimi, respekti reciprok, i cili të çon në shmangie të konflikteve.

| **Burimet**<br>- Teksti i nxënësit,<br>- materiale nga interneti,<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. | **Lidhjet me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Shkencat shoqërore dhe mjedisi<br>- Gjuha dhe komunikimi |
|---|---|

**Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

**Detyrë: Prezantoni tri shërbimet me të suksesshme për komunitetin tuaj. Përpiquni të ilustroni përzgjedhjen tuaj.**



## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Qytetaria</th><th>Lënda: Qytetaria</th><th>Shkalla: III</th><th>Klasa: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Tregtia</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Listoni mallra bujqësore, industriale që prodhohen në vend dhe që vijnë nga jashtë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi:<br>• Përkufizon termin tregti<br>• Dallon eksportin nga importi<br>• Liston mallrat që prodhohen në vend e ata që vijnë nga jashtë.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>Tregti, tregu global, import, eksport.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>Teksti, informacione vetjake nga dokumentarë ose interneti ose nga përvoja familjare.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>Gjeografia</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>Kompetencat e të menduarit:<br>• Shpreh mendime të ndryshme mbi tregun dhe llojet e tyre.<br>• Jep shembuj të produkteve e shërbimeve për një biznes të rëndësishëm.<br>Kompetenca qytetare:<br>• Shpreh mendimin e tij mbi sistemin e prodhimeve në vend, të cilat rrisin punësimet.<br>• Shpjegon domosdoshmërinë e higjienës në tregje.<br>Kompetenca digjitale:<br>• Vlerëson informacionet e marra elektronikisht mbi rolin e tregut global në marrëdhëniet mes popujve me kultura të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">• Shkruhen në dërrasë termat paraprak: treg, tregu brendshëm, tregu global, eksport-import.<br>• Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe saktësohen nga mësuesit duke i shkruar në dërrasë.<br><br>Harta e të pyeturit:<br>• Për të jetuar njerëzit kanë nevojë vetëm për produkte ushqimore.<br>• A mund të prodhohen të gjitha në një vend?<br>• Pse njerëzit hyjnë në shkëmbime tregtare me njëri – tjetrin ose me një shtet tjetër?<br>• Çfarë është tregu? Llojet e tregjeve.<br>• Trego shërbime brenda vendit (p.sh. molla nga Korça ose Dibra në Tiranë)<br>• Tregtia e jashtme, ndërkombëtare ose globale; p.sh. mjete elektronike nga Kina në Shqipëri.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| • Kur kemi eksport? Mallra nga brenda-> jashtë<br>• Kur kemi import? Mallra ose shërbime nga jashtë -> brenda.<br><br>Ndahet klasa në dy grupe dhe nxënësit i bëjnë pyetje njëri – tjetrit jo vetëm më kuptimin e koncepteve kryesore: treg, shkëmbim, import, eksport, tregu global, shërbime.<br>Njëri grup liston mallra që lëvizin nga një vend jashtë Shqipërisë dhe grupi tjetër mallrat që dalin nga Shqipëria.<br><br>*Diskutim:*<br>• Si kanë ndikuar këto mallra në jetën tonë?<br>• Sa ndikojnë shkëmbimet midis vendeve me kultura të ndryshme?<br>• A duhet që mallrat që mund t'i prodhojmë vetë t'i importojmë nga jashtë? Pse? |
| **Vlerësimi:**<br>Vlerësimi i nxënësve do të kryhet për pjesëmarrjen aktive gjatë orës së mësimit, për punën në grup si dhe për mendimet dhe pjesëmarrjen në diskutim. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Bëni një listë me produkte të cilat do të donit t'i sillnit nga jashtë duke treguar dhe fushat ku do t'i përdornit. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha:** Qytetaria | **Lënda:** Qytetaria | **Shkalla:** III | **Klasa:** VI |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Barrierat dhe marrëveshjet tregtare | | **Situata e të nxënit:**<br>Trego raste kur në tregti ka "Fitues" apo "Humbës". | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës** mësimore:<br>• Të tregojmë sa e rëndësishme është politika tregtare.<br>• Të vlerësojmë marrëveshjet shumëpalëshe të cilat mund të lehtësojnë tregtinë.<br>• Të respektohen vendimet (O.B.T) Organizata Botërore e Tregtisë që zgjidhin mosmarrëveshjet tregtare. | | **Fjalët kyçe:**<br>Embargo, tarifa, kuota, standarde, subvencion, barriera, konsumator. | |
| **Burimet:**<br>Teksti, informacione vetjake nga interneti. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjeografi, Histori. | |

**Rezultatet e të nxënit** sipas kompetencave **kyçe**

*Kompetencat e të nxënit:*:

- Nxënësi zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga burimi (teksti) mbi marrëveshjet shumëpalëshe.

*Kompetenca e të menduarit:*

- Nxënësi shpreh mendimin e tij mbi politikat tregtare që duhet të planifikojë qeveria.

*Kompetenca qytetare:*

- Nxënësi zbaton dhe respekton me përpikmëri ligjet mbi prodhuesit dhe konsumatorët.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

Jepen termat: kuota, tarifa, subvencione, embargo, marrëveshje shumëpalëshe, standarde.




Nxënësit japin mendimet e tyre shoqëruar me shembuj nga jeta e përditshme.

<u>*Debat:*</u>

- Kur ka fitues dhe humbës në tregti?

Mësuesja sqaron elementët që përfshijë barrierat tregtare:

- Sasia e makinave => kuota
- Taksa që vendos shteti përcakton çmimin në treg => tarifa
- Ndihma financiare që shteti i jep prodhuesit => subvencion
- Ndalimi i mallrave të infektuara (pula, çokollata) => embargo
- Përcaktimi i cilësive të mallit => standard
- O.B.T: Lehtëson tregtinë globale
- Zgjidh mosmarrëveshjet

Në mënyrë të pavarur nxënësit të plotësojnë ushtrimin 1 fq 66.

<u>*Diskutim:*</u>

Pasi nxënësit të lexojnë rastin 1 dhe 2 fq 67, të japin mendimet e tyre mbi domosdoshmërinë e zbatimit të ligjeve në marrëdhëniet tregtare.

| |
|---|
| **Vlerësimi:**<br>Nxënësit inkurajohen dhe vlerësohen mbi pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë orës së mësimit. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Bëni një tregim të shkurtër me temë: "Siguria ushqimore, shëndet i garantuar". |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Qytetaria</td><td>Lënda: Qytetaria</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VI</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Bëjmë një marrëveshje</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Krijoni një linjë ushqimore të çastit në lagjen tuaj me ndihmën e një biznesmeni.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>• Përcakton praktikat e biznesit në vende me kultura të ndryshme.<br>• Të dallojë kufizimet tregtare të shtetit.<br>• Të planifikojë biznesin në përputhje me ligjin e shtetit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>Ushqim tradicional, planifikim biznesi, praktika biznesi, kartvizita.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>Teksti, informacione elektronike.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>Gjuha, Komunikimi, Shkenca shoqërore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>Kompetencat e të menduarit::<br>• Nxënësi shpreh mendimin për bashkëpunim dhe respektim reciprok të marrëveshjes tregtare mes shteteve me kultura të ndryshme.<br>Kompetenca digjitale:<br>• Hulumton informacione përmes internetit mbi detajet e marrëveshjeve tregtare me shtete të ndryshme.<br>Kompetenca qytetare:<br>• Respekton me mirësjellje traditat, rregullat dhe ligjet e vendit me të cilin do të bashkëpunohet.<br>• Vlerësojnë bashkëpunimin e partnerëve tanë tregtarë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Në dërrasë të shkruhen termat: Planifikim biznesi, ushqim tradicional, kartvizitë, marrëveshje, kulturë biznesi.<br><br>Nxënësit për 5 minuta të shkruajnë 1-2 fjali me termat e mësipërm duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve:</td></tr>
</table>

| |
|---|
| • Pse nevojitet kartvizita?<br>• A duhet të njihni kulturën, gjuhën, veshjet e banorëve të X shteti me të cilin do bëni marrëveshje?<br>• Për çfarë duhet dhe nuk duhet të flisni në një takim biznesi?<br>• A mund t'i drejtoheni me emër?<br>• Pse duhet të njihni kufizimet ushqimore të shtetit?<br>• Duhet të njihni ushqimin tradicional te shtetit?<br>• Si duhet të visheni në një takim biznesi?<br><br>*Loje me role:*<br>Pasi kanë lexuar: Si të bëni biznes në Indi; Si të bëni biznes në Japoni fq 70-71 zhvilloni biseda mes dy biznesmenëve lidhur me produkte të ndryshme. Përmes bashkëbisedimit duhet të keni parasysh veçoritë e shtetit nga i cili vjen zyrtari, përfshirë komunikimin, sjelljen, veshjen, kulturën, ushqimin tradicional.<br>V.O.- <u>Mos harroni asnjëherë kartvizitën</u> – tregon seriozitet, besueshmëri.<br>Në fund diskutimi bëhet i hapur për fillimin ose jo të marrëveshjes: <u>Mos thuaj asnjëherë jo, ose shmangeni atë.</u> |
| **Vlerësimi:**<br>Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë orës së mësimit dhe në arritjen e marrëveshjes. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Përshkruani një praktikë biznesi për një vend të cilin keni vizituar dhe njihni pjesë te kulturës së tij, përfshirë dhe gjuhën. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha:** Qytetaria | **Lënda:** Qytetaria | **Shkalla:** III | **Klasa:** VI |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Roli i individëve si burime njerëzore | | **Situata e të nxënit:**<br>Leximi "Një histori emigranti" fq. 74. (I jepet të lexohet në fillim të orës). | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**:<br>• Të përshkruajë arsyet e lëvizjes së njerëzve nga një vend në tjetrin.<br>• Të tregojë vështirësitë që hasin njerëzit në vende të reja.<br>• Të dallojë vendet ku tregon lëvizjet më të mëdha të shqiptarëve. | | **Fjalët kyçe:**<br>Burime njerëzore, emigrim, sipërmarrës. | |
| **Burimet:**<br>Teksti, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Shkenca shoqërore, komunikimi, historia, gjeografia. | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

*Kompetencat e të menduarit::*

- Shpreh mendimin e tij në lidhje me lëvizjen nga Shqipëria, në drejtim të vendeve të tjera duke evidentuar arsyet.

*Kompetenca e komunikimit:*

- Dëgjon me vëmendje dhe respekton prezantimet e shokëve edhe kur mendimet e tyre janë të ndryshme.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e koncepteve të reja.

*Kompetenca qytetare:*

- Respekton gjuhën dhe kulturat e popujve të ndryshëm e ku duhet të mbizotërojë toleranca.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

Përmes këtij kllasteri mësuesja hap debat në klasë:




Pasi keni lexuar në fillim të orës leximin "Histori imigranti" fq 74 diskutojmë së bashku.

Në fillim pyetet klasa nëse ndonjë nga nxënësit ka kaluar eksperienca të tilla në ndonjë vend tjetër, duke përshkruar situatat në të cilat është ndodhur atje.

*Debat:*

- Cilat janë arsyet e largimit?
- A ka ndryshuar jeta e emigrantëve?
- Ç'vështirësi keni hasur atje?
- A jeni ndjerë të barabartë me moshatarët tuaj?
- A ju kanë diskriminuar ndonjëherë?

- Ç'vështirësi pati në fillim djali në SH.B.A? (plotëso)




Përfytyroni sikur bashkë me familjen do të largoheni në një vend të huaj (caktoni vendin: Itali, Greqi, Gjermani, SH.B.A.).

Ndahet klasa në katër grupe dhe përgatisni bagazhet që do merrni me vete sipas këtyre pyetjeve duke paketuar__.__.__.__ (2-3 artikuj për çdo rubrikë):

1- Artikuj për t'u argëtuar ->

2- Artikuj që lidhen me suksesin tuaj ose të familjes ->

3- Artikuj mbi historinë e familjes ->

4- Artikuj që kanë vlerë për ju ->

- Nëse do të shtonit artikuj të tjerë, cilët do të ishin ata?

Nisur nga përvoja e nxënësve që janë kthyer nga jashtë në Shqipëri:

- Me çfarë vështirësish janë hasur këta fëmijë?
- Çfarë ndihme keni dhënë ju për t'ua lehtësuar vështirësitë?
- Pse ka vlerë për ne të studiojmë sa më mirë gjuhën angleze?

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet gjatë orës përmes mendimeve të tyre, pjesëmarrjes në diskutim dhe rolet e tyre në punën në grup.

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

Merrini një intervistë një shoku ose shoqeje, ku përmes një pyetësori të tregojë rrugëtimin e tij në një shtet të huaj, ku të tregojë jo vetëm vështirësitë, por edhe gjërat pozitive që përfitoi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Qytetaria</td><td>Lënda: Qytetaria</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VI</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Bota e fjalëve</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Çfarë vështirësish kishin njerëzit në përhapjen e librave, kur deri në 1400 nuk kishte shtypshkronjë dhe librat shkruheshin me dorë?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>• Të tregojë vështirësitë e hartimit të librave.<br>• Të vlerësojë rolin e teknologjisë në përhapjen e librave.<br>• Të përkufizojë dhe llogarisë rendimentin.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>Shkrues, teknologji, shpikje, informacion, rendiment, kompjuter.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>Teksti, materiale nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>Letërsia, Historia, Interneti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>Kompetencat e të menduarit::<br>• Të zhvillojë mendimin kritik dhe krijues mbi zhvillimet në teknologjinë e internetit.<br>Respekt reciprok dhe bashkëpunim:<br>• Nxënësi të shprehë mendimin e tij mbi rëndësinë e qarkullimit të ideve.<br>• Të lexojë rrjedhshëm informacionet mbi shpikjet e shek. XV që çuan në krijimin e shtypshkronjës Gutenberg.<br>• Të dëgjojë me respekt e vëmendje komentet e shokëve rreth kësaj teme.<br>Kompetenca qytetare:<br>• Të shpjegojë domosdoshmërinë dhe respektin ndaj rregullave e ligjeve të një shoqërie ku në themel është bashkëpunimi, i cili shmang konfliktet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Kujto nga mësimet e mëparshme:<br>• Lëvizja e mallrave -> tregti<br>• Lëvizja e njerëzve -> migrim<br>• Lëvizja e ideve -> interneti, TV, radio<br></td></tr>
</table>

| |
|---|
| *Diskutim:*<br>• Pse janë të rëndësishëm librat?<br>• A keni bibliotekë në shtëpi?<br>• Blini libra të rinj në panaire?<br><br>• Deri në shek. XV librat shkruheshin me dorë. Tregoni vështirësitë.<br>• Letrat nga Europa në Amerikë me anije___ duheshin muaj.<br>Gutenberg => 1455 => shtypshkronja parë => 500 libra/javë.<br><br>• Lexohet dhe komentohet në fq. 77 "A e dini se?"<br>• Rendimenti => sasia=> në një kohë të caktuar.<br>• Rendimenti varet nga: Koha, mjeti që përdoret, njeriu<br>• Nqs një person shkruan 2 fq në 1 orë => Rendimenti= 2fq/ore<br><br>*Debat në grupe:*<br>• Pse është i rëndësishëm përmirësimi i teknologjisë: a-komunikimi, b- komunikim c- transport<br>• Sa ju ndihmon interneti në procesin e të mësuarit?<br>• Pse shpikja e makinës së shtypit vlerësohet si një ndër shpikjet më të mëdha të njerëzimit? |
| **Vlerësimi:**<br>Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për pjesëmarrje aktive në zhvillimin e orës së mësimit në rubrika të ndryshme (diagnostikues dhe të vazhdueshme) |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Një tregim të shkurtër ku të flitet mbi shpikjet që kanë ndihmuar në qarkullimin e informacionit. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha:** Qytetaria | **Lënda:** Qytetaria | **Shkalla:** III | **Klasa:** VI |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Bota e parave | | **Situata e të nxënit:**<br>Trego si vepron kur shkon në një shtet të huaj. Çfarë monedhe përdor për të blerë veshje atje? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**:<br>• Të tregojë rolin e parave në jetën e përditshme.<br>• Të shpjegojë pse tregtia ndërkombëtare kërkon këmbimin e monedhave. | | **Fjalët kyçe:**<br>Monedha, vlerë këmbimi. Euro, Dollar, zhvlerësim, kurs këmbimi | |

<table>
<tr><td>

- Të njohë kursin e këmbimit për të konvertuar lekun në një monedhë tjetër.

</td><td></td></tr>
<tr><td>

**Burimet:**<br>Teksti, nxënësit, burimet vetjake të nxënësit.

</td><td>

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjeografia, Informatika.

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>*Kompetencat e të menduarit:*<br>• Nxënësi ja shpreh mendimin për domosdoshmërinë e njohjes së kursit të këmbimit, sidomos të atij vendi ku do shkojë.<br>*Kompetenca digjitale:*<br>• Të menaxhojë saktë informacionet mbi qarkullimin e monedhave.<br>*Kompetenca qytetare:*<br>• Të respektojë rregullat e mirësjelljes, ligjet e kulturat e shteteve të ndryshme, duke shmangur çdo konflikt.

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

• Lek->Dollar->Euro<br>• Shqipëri->Amerikë->Itali<br>Blejmë mallra dhe shërbime<br><br>• Çfarë janë agjencitë e këmbimit?<br>• Nqs 1 Euro=140 lekë, sa lek do të duhen për të këmbyer 100 Euro? 120 Euro? 180 Euro?<br>Nqs në Shqipëri një pako çamçakëzë bën 70 lekë dhe në Kosove 0,5 Euro, ku kushton më shtrenjtë?<br>A ndryshon kursi i këmbimit?<br>Vlerësimi -> kur ...........................<br>Zhvlerësimi -> kur me 1 Euro blen më pak lekë.<br>• Ç' është monedha?<br><br>*Punë individuale:* plotësoni tabelën 3 fq 81.<br><br><u>*Punë në grupe*</u>:<br>Ndahet klasa në 4 grupe dhe secili grup përllogarit shumën e Eurove që i buhet me vete për të blerë:<br><br>**Grupi 1:**<br>90 palë xhinse<br>100 palë atlete<br>1 palë xhinse 40 Euro<br>1 palë atlete 60 Euro

</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **Grupi 2:**<br>TV- 80 copë<br>Lavatriçe – 250 copë<br>1 TV = 220 Euro<br>1 Lavatriçe = 210 Euro<br><br>**Grupi 3:**<br>100 çanta shkolle<br>1000 stilolapsa<br>4000 fletore<br>1 çantë = 30 Euro<br>1 stilolaps = 0.5 Euro<br>1 fletore = 0.5 Euro<br><br>**Grupi 4:**<br>Banane 3000 kg<br>Kivi 1500 kg<br>Arra 2000 kg<br>1 kg banane = 1 Euro<br>1 kg kivi = 1 Euro<br>1 kg arra = 3 Euro<br><br>Duhet të mbahet parasysh se në të gjitha rastet kursi i këmbimit është 1 Euro = 140 Lekë. |
| **Vlerësimi:**<br><br>Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për pjesëmarrjen aktive në zhvillimin e orës së mësimit. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Përshkruaj një vizitë që ke bërë kohët e fundit në një vend të huaj dhe lekët që ke shpenzuar (së bashku me prindërit) (avion, hotel, restorant, shopping) |